

## **AKT THEMELIMI**

### **I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

#### **"OKAZION" SHPK**

Në Tiranë, sot me date 13.06.2019, u mbajt ky akt themelimi, SILVER TOPALLI, i biri i Gezimit, i datëlindjes 05.02.1992, lindur në Fier, dhe banues në Tirane, me Nr Personal J20205096P, i cili me cilesine e "Ortakut të vetëm Themelues, redaktoi këtë akt themelimi, nepemjet te cilit deklaroi se me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin Nr. 131/2015 date 26.11.2015" Per Qendren Kombetare te Biznesit", ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per shoqerite tregtare ", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin , **"OKAZION" SHPK**

#### **KREU I**

#### **Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti**

##### **Neni 1**

##### **Emertimi**

Emertimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **"OKAZION" SHPK**

##### **Neni 2**

##### **Forma Juridike**

Shoqëria **"OKAZION" SHPK** është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshtë e quajtur "Shoqëria").

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **"OKAZION" SHPK**, është një e tillë, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakët të cilët përballojnë humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.



### Neni 3

#### Selia

Shoqëria e ka selinë në TIRANË Njësia Administrative nr.9, Rruga Albanopoli, Ndertesa 43, Hyrja 3, 1016

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

### Neni 4

#### Objekti i veprimtarisë


Studimin, projektimin dhe realizimin e reklamave / publicitetit dhe fushatave publicitare në përgjithësi, për vetë dhe të tretet, duke e ushtruar këto aktivitete pa kushtezuar mjetet dhe / ose menyrat, me përjashtim kur ndalohet me ligj. Aktiviteti do ushtrohet nëpërmjet Platformës www.okazion.online

Projektimin, realizimin dhe menaxhimin e tregtisë elektronike në internet dhe të botimeve elektronike në përgjithësi;

Sherbime teknologjia informacioni web it etj, digital marketing, google ads social network distribution dhe tregtim të sistemeve të teknologjisë së informacionit për përpunimin e të dhënave të të gjitha llojeve si: hardware, software, networking dhe të gjithë periferikeve të tyre. Montim aparaturash të sipër permendura, parametrizim, konfigurim. b. Disenjim software-i. Këtu përfshihet analiza e kërkesave të sistemit software, projektimi i arkitekturës dhe projektimi i detajuar i sistemit software; c. Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software. Këtu përfshihet programimi i sistemeve software, kodimi, instalimi, integrimi i të gjithë komponenteve, dokumentimi, identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve, modifikimet (pas momentit që software-i është vendosur në operim), mirëmbajtja e të gjithë komponenteve, suporti i sistemit si një teresi komponentesh, që, në funksionimin e tyre, realizojnë qëllimin e Zgjidhjes Informatike. d. Testim software. Këtu përfshihet testimi i funksionaliteteve, të ngarkesës në punë, të performancës, të pranimit, të disponueshmërisë dhe të sigurisë së sistemit software. e. Disenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit. Këtu përfshihet analiza, planifikimi, projektimi, zbatimi, vendosja në punë dhe mirëmbajtja e sistemeve të komunikimit të rrjeteve të pajisjeve informatike (LAN/ WAN/ WLAN/ MAN/ SAN/ CAN). f. Disenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë. Këtu përfshihet analiza e kërkesave të sigurisë së klientit, projektimi i arkitekturës, instalimet dhe konfigurimet e komponenteve, vendosja në punë, testimet e sigurisë dhe mirëmbajtja përkatëse. g. Zhvillim sistemesh migrimi. Këtu përfshihet transferimi i të dhënave dhe infrastrukturës përkatëse nga një teknologji e vjetër në një teknologji të re. h. Përmirësim/upgrade sistemesh informatike. i. Operimi, menaxhimi, suporti i përdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik për sistemet software. j. Nderim, zhvillim dhe operim i qendrave të të dhënave. k. Import - eksport të produkteve/sherbimeve të permendura në këto nën të cilat janë të klasifikuara me përdorim të dyfishtë. Shoqëria mund të kryejë edhe veprimtari të tjera ndihmëse të cilat mbështesin arritjen e qëllimit të saj kryesor në përputhje me legjisllacionin shqiptar në fuqi.

Gjithashtu, për realizimin e qëllimeve lidhur me objektin: Shoqëria mund të delegojë agjencive apo subjekteve të regjistruara sipas ligjit për të blerë, shitur, përdorur dhe transferuar patenta, marka dhe sherbime të tjera referuar inteligjencës humane, si edhe të gjitha sherbimet e përfshira në objektin e shoqërisë, për të kryer dhe promovuar kërkime të tregut dhe përpunime të dhënash.

Shoqëria, për arritjen e objektit të saj, mund të kryejë të gjitha operacionet tregtare, industriale që lidhen me pronat e paluajtshme, të shesë të blejë biznese, të nënshkruajë kontrata qiraje biznesi, si qiramarrës apo qiradhenës, të blejë ose të shesë marka apo patenta, të nënshkruajë kontrata leasing.



**Neni 5**  
**Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

**KREU II**  
**KAPITALI**

**Neni 6**  
**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10.000,00 lekë dhe eshte i ndare në 1 pjesë. Pjesëmarrja në përqindje (%) 100,00.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe shlyer tërësisht ne te holla nga ortaku i vetëm shoqerise perkatesisht :

**Silver Topalli, 100 % të kapitalit.**

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

**Neni 7**  
**Transferimi i kapitalit**

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Asamblese së ortakëve .

Secili nga ortakët ka te drejte te bleje kuoten e pjesmarrjes ne shoqeri qe ortaku tjetër (ketej e me poshte i quajtur dhenesi ) ka nder mend te jape me tituj detyrimi ose gratis.

Dhenesi duhet tju komunikojë ortakëve të tjerë, ne adresen qe rezulton ne librin e ortakëve, synimin per te dhene kuotat e tij, duke treguar pranuesin dhe modalitetet e negociimit te transferimit. Brenda 30 diteve nga marrja e ketij komunikimi, ortakët duhet te dergojne nje komunikim dhenesit dukedeklaruar se duan te blejne te tere kuoten, objekt i transferimit. Ne mungese, kuota mund ti transferohet pranuesit . Nese me shume ortakë deklarojne se duan te blejne, ata duhet te behen bleres te kuotave ne fjale, ne proporzion me kuotat qe ata kane ne shoqeri. Ne komunikimin qe do ti bejne dhenesit, ortakët qe duan te blejne kuotat do te kene te drejten per te paraqitur afatin brenda te cilit do te procedojne per blerjen e pjesmarrjes shoqerore.

Ky afat nuk mund te jete me i madh se 3 muaj nga data qe i eshte derguar komunikimi dhenesit.

Me qellim ushtrimin e te drejtes se blerjes, cmimi percaktohet ne baze te situates pasurore te shoqerise, rendimentit te saj, vleres se te mirave materiale dhe jo materiale ne pronesi te saj si dhe cdo rrethane apo kushti qe merret ne konsiderate per te percaktuar vleren e pjesemarrjes shoqerore. Ne mungese te nje marreveshje mbi cmimin ne baze te ketij kriteri, ai do te percaktohet nga nje ekspert i emeruar nga Gjykata e qytetit ne te cilen shoqeria ka seline.



Te gjitha komunikimet si me siper duhet te behen me leter rekomande ose te dorezuar ne dore dhe te kunderfirmosura. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

### **KREU III** **ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8** **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakeve brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratorët.

Vendimet merren pas konsultimit me shkrim të ortakëve, në rast se ortakët miratojnë me shkrim përmbajtjen e konsultimit.

Ortakët lajmërohen me letër rekomande të paktën 7 ditë përpara mbledhjes së asamblesë. Në këtë letër njoftohet rendi i ditës. Lajmërimi bëhet nga administratori ose ortaku perfaqësues 5% te kapitalit.

Asambleja do te jete e vlefshme edhe pse nuk eshte mbledhur ne peputhje me dispozitat si me siper nese ne marrjen e vendimit perkates te kete marre pjese i gjithe kapitali shoqeror dhe te gjithe adminstratoret, nese jane emeruar, te jene te pranishem ose te informuar per mbledhjen dhe asnje nuk kundershton trajtimin e argumentit. Secili ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendime dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai zotëron. Secili ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër. Ai mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër person, nepermjet prokures.

#### **Neni 9** **Ndryshimet e Statutit**

Ndryshimet e statutit ( si tranferimi i kapitalit, zmadhimi i kapitalit shoqeror, financimet etj, ) duhet detyrimisht te vendosen me miratimin e ortakëve (që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

#### **Neni 10** **Administrimi**

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te ortakeve.



Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Ortakët vendosin për sistemin e administrimit dhe në rastin e një organi administrativ me shumë administratore, përcaktojnë numrin dhe kompetencat e tyre.

Administratori/administratoret, mund të jenë ose jo ortakë të shoqërisë.

Administratori mund të shkarkohet në çdo kohë.

Administratori i shoqërisë është **SILVER TOPALLI**, i biri i **Gëzimit**, i datëlindjes 05.02.1992, lindur në Fier, dhe banues në Tiranë, me Nr Personal J20205096P.

Administratori i shoqërisë emërohet në këto detyra dhe ka kompetencat për një periudhë të përcaktuar sipas ligjit. (pese vjeçar)

### Neni 11

#### Kompetencat

Shoqëria administrohet nga Administratori. Administratori është i pajisur me kompetencat me të gjera për manaxhimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë, me përjashtim të atyre operacioneve kur në ligj ose nëpërmjet këtij statuti i është rezervuar vendimeve të ortakëve.

Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, vec e vec ose së bashku, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ua jep shprehimisht ortakëve.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Administratori ka gjithashtu të drejtë të nënshkruajë kontrata të ndryshme në emër e për llogari të Shoqërisë, përfshi këtu kontratat e qirasë, shitjes, blerjes a hipotekimit të pasurive të paluajtshme, të nënshkruajë aktet e themelimit të shoqërive të tjera ku Shoqëria është ortak, të nënshkruajë e hartojë çdo dokument e të kryejë në emër të Shoqërisë çdo veprim përballë të gjitha Bankave shqiptare apo të huaja në lidhje me çeljen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse të Shoqërisë, nënshkrimin e kontratave të ndryshme bankare për financimin e Shoqërisë si dhe të kryejë veprime tërheqje e derdhje shumash nga këto llogari pa limit.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i Administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

### Neni 12



### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

### Neni 13

#### Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar sic mund të jene :

- a) Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.
- b) Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"
- c) Kur plotesohet afati i caktuar per ushrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

### Neni 14

#### Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi, statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

### Neni 15

#### Mosmarveshjet

Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e statuti, si dhe per çdo mosmarveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

### Neni 16

#### Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tyre orgjinale.

### **ORTAKU THEMELUES**

**SILVER TOPALLI**

SILVER TOPALLI

Tirane, me 18 . 06 . 2019



## STATUT

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### "OKAZION" SHPK

#### KREU I

#### Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

##### Neni 1

##### Emertimi

Emertimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "OKAZION" SHPK

##### Neni 2

##### Forma Juridike

Shoqëria "OKAZION" SHPK është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshtë e quajtur "Shoqëria").

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "OKAZION" SHPK është një e tillë, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakët që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

##### Neni 3

##### Selia

Shoqëria e ka selinë në TIRANË Njësia Administrative nr.9, Rruga Albanopoli, Ndertesë 43, Hyrja 3, 1016.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyrë përfaqësie, dege, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

##### Neni 4

##### Objekti i veprimtarisë

Studimin, projektimin dhe realizimin e reklamave / publicitetit dhe fushatave publicitare në përgjithësi, për vetë dhe të tretet, duke e ushtruar këtë aktivitet pa kushtëzuar mjetet dhe / ose menyrat, me përjashtim kur ndalohet me ligj. Aktiviteti do ushtrohet nepermjet Platformës [www.okazion.online](http://www.okazion.online)

Projektimin, realizimin dhe menaxhimin e tregtisë elektronike në internet dhe të botimeve elektronike në përgjithësi;

Shërbime teknologjia informacioni web it etj, digital marketing, google ads social network distribution dhe tregtim të sistemeve të teknologjisë së informacionit për përpunimin e të dhënave të të gjitha llojeve si: hardware, software, networking dhe të gjithë periferikeve të tyre. Montim aparaturash të siper përmendura, parametrizim, konfigurim. b. Disenjim software-i. Këtu përfshihet analiza e kërkesave të sistemit software, projektimi i arkitektureve dhe projektimi i detajuar i sistemit software; c. Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software. Këtu përfshihet programimi i sistemeve software, kodimi, instalimi, integrimi i të gjithë komponenteve, dokumentimi, identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve, modifikimet (pas momentit që software-i është vendosur në operim), mirëmbajtja e të gjithë komponenteve, suporti i sistemit si një tjerësi



komponentesh, qe, ne funksionimin e tyre, realizojne qellimin e Zgjidhjes Informatike. d. Testim software. Ketu perfshihet testimi i funksionaliteteve, te ngarkeses ne pune, te performances, te pranimit, te disponueshmerise dhe te sigurise se sistemit software. e. Disenjim dhe zhvillim sistemesh te komunikimit. Ketu perfshihet analiza, planifikimi, projektimi, zbatimi, vendosja ne pune dhe mirembajtja e sistemeve te komunikimit te rrjeteve te pajisjeve informatike (LAN/ WAN/ WLAN/ MAN/ SAN/ CAN). f. Disenjim dhe zhvillim sistemesh te sigurise. Ketu perfshihet analiza e kerkesave te sigurise se klientit, projektimi i arkitekturës, instalimet dhe konfigurimet e komponenteve, vendosja ne pune, testimet e sigurise dhe mirembajtja perkatese. g. Zhvillim sistemesh migrimi. Ketu perfshihet transferimi i te dhenave dhe infrastruktures perkatese nga nje teknologji e vjeter ne nje teknologji te re. h. Permiresim/upgrade sistemesh informatike. i. Operimi, menaxhimi, suporti i perdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik per sistemet software. j. Ndertim, zhvillim dhe operim i qendrave te te dhenave. k. Import - eksport te produkteve/sherbimeve te permendura ne kete nen te cilat jane te klasifikuara me perdorim te dyfishte. Shoqeria mund te kryeje edhe veprimtari te tjera ndihmese te cilat mbeshtetin arrijten e qellimit te saj kryesor ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Gjithashtu, per realizimin e qellimeve lidhur me objektin: Shoqeria mund ti delegoje agjencive apo subjekteve te regjistruara sipas ligjit per te blere, shitur, perdorur dhe transferuar patenta, marka dhe sherbime te tjera referuar inteligjences humane, si edhe te gjitha sherbimet e perfshira ne objektin e shoqerise, per te kryer dhe promovuar kerkime te tregut dhe perpunime te dhenash.

Shoqeria, per arrijten e objektit te saj, mund te kryeje te gjitha operacionet tregtare, industriale qe lidhen me pronat e paluajtshme, te shese te bleje biznese, te nenshkruaje kontrata qiraje biznesi, si qiramarrës apo qiradhenes, te bleje ose te shese marka apo patenta, te nenshkruaje kontrata leasing.

## **Neni 5**

### **Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

## **KREU II**

### **KAPITALI**

## **Neni 6**

### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10.000,00 lekë dhe eshte i ndare në 1 pjesë, Pjesëmarrja në përqindje (%) 100,00.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe shlyer tërësisht ne te holla nga ortaku i vetëm shoqerise perkatesisht :

**SILVER TOPALLI, 100 % të kapitalit.**

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;



## **Neni 7**

### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit, detyrimisht me aprovimin e ortakëve që përfaqesojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e pjesës së kapitalit

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqesojnë.

Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në të kundërt shoqëria duhet të shndërrohet në një

formë tjetër. Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo person i interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë.

Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mbledhet për të marrë vendim.

## **Neni 8**

### **Transferimi i kapitalit**

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e asamblese së ortakëve

Secili nga ortakët ka të drejtë të blejë kuotën e pjesëmarrjes në shoqëri që ortaku tjetër (ketej e me poshtë i quajtur dhenesi ) ka nder mend të japë me tituj detyrimi ose gratis.

Dhenesi duhet tju komunikojë ortakëve të tjerë, në adresën që rezulton në librin e ortakëve, synimin për të dhënë kuotat e tij, duke treguar pranuesin dhe modalitetet e negociimit të transferimit. Brenda 30 diteve nga marrja e këtij komunikimi, ortakët duhet të dergojnë një komunikim dhenesit duke deklaruar se duan të blejnë të tere kuotën, objekt i transferimit. Në mungesë, kuota mund të transferohet pranuesit. Nëse me shumë ortakë deklarohen se duan të blejnë, ata duhet të behen bleres të kuotave në fjale, në proporzion me kuotat që ata kanë në shoqëri. Në komunikimin që do të bëjnë dhenesit, ortakët që duan të blejnë kuotat do të kenë të drejtën për të paraqitur afatin brenda të cilit do të procedojnë për blerjen e pjesëmarrjes shoqërore.

Ky afat nuk mund të jete më i madh se 3 muaj nga data që i është derguar komunikimi dhenesit.

Me qëllim ushtrimin e të drejtës së blerjes, cmimi përcaktohet në baze të situatës pasurore të shoqërisë, rendimentit të saj, vlerës së të mirave materiale dhe jo materiale në pronësi të saj si dhe çdo rrethane apo kushti që merret në konsideratë për të përcaktuar vlerën e pjesëmarrjes shoqërore. Në mungesë të një marrëveshje mbi cmimin në baze të këtij kriteri, ai do të përcaktohet nga një ekspert i emëruar nga Gjykata e qytetit në të cilën shoqëria ka selinë.

Te gjitha komunikimet si me sipër duhet të behen me leter rekomande ose të dorëzuar në dorë dhe të kunderfirmosura.



Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

### **KREU III** **ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 9**

##### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakeve brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratorët.

Vendimet merren pas konsultimit me shkrim të ortakëve, në rast se ortakët miratojnë me shkrim përmbajtjen e konsultimit.

Ortakët lajmërohen me letër rekomande të paktën 7 ditë përpara mbledhjes së asamblesë.

Në këtë letër njoftohet rendi i ditës. Lajmërimi bëhet nga administratori ose ortaku qe perfaqson 5% te kapitalit.

Asambleja do te jete e vlefshme edhe pse nuk eshte mbledhur ne peputhje me dispozitat si me siper nese ne marrjen e vendimit perkates te kete marre pjese i gjithë kapitali shoqeror dhe te gjithë adminsitratores apo sindakalistet, nese jane emeruar, te jene te pranishem ose te informuar per mbledhjen dhe asnje nuk kundershton trajtimin e argumentit.

Secili ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendime dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai zotëron. Secili ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër.

Ai mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër person, nepermjet prokures.

#### **Neni 10**

##### **Ndryshimet e Statutit**

Ndryshimet e statutit ( si tranferimi i kapitalit, zmadhimi i kapitalit shoqeror, financimet etj, ) duhet detyrimisht te vendosen me miratimin e ortakëve qe perfaqesojne te pakten  $\frac{3}{4}$  e pjeses se kapitalit

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

#### **Neni 11**

##### **Administrimi**

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te ortakeve.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Ortakët vendosin per sistemin e administrimit dhe ne rastin e nje organi administrativ me shume administratore, percaktojne numrin dhe kompetencat e tyre.

Administratori/administratores, mund te jene ose jo ortake te shoqerise.

Administratori mund te shkarkohet ne cdo kohe.



Administrator i shoqërisë është **SILVER TOPALLI**, i biri i **Gëzimit**, i datëlindjes 05.02.1992, lindur në Fier, dhe banues në Tiranë, me Nr Personal J20205096P.

Administratori i shoqërisë emërohet në këto detyra dhe ka kompetencë për një periudhë të përcaktuar sipas ligjit. (pese vjeçar)

### **Neni 12**

#### **Kompetencat**

Shoqëria administrohet nga një Administrator i vetëm. Administratori është i pajisur me kompetencat me të gjera për menaxhimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë, me përjashtim të atyre operacioneve kur në ligj ose nëpërmjet këtij statuti është rezervuar vendimeve të ortakëve.

Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, vec e vec ose së bashku, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ua jep shprehimisht ortakëve.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Administratori ka gjithashtu të drejtë të nënshkruajë kontrata të ndryshme në emër e për llogari të Shoqërisë, përfshi këtu kontratat e qirasë, shitjes, blerjes a hipotekimit të pasurive të paluajtshme, të nënshkruajë aktet e themelimit të shoqërive të tjera ku Shoqëria është ortak, të nënshkruajë e hartojë çdo dokument e të kryejë në emër të Shoqërisë çdo veprim përballë të gjitha Bankave shqiptare apo të huaja në lidhje me çeljen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse të Shoqërisë, nënshkrimin e kontratave të ndryshme bankare për financimin e Shoqërisë si dhe të kryejë veprime tërheqje e derdhje shumë nga këto llogari pa limit.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i Administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

### **Neni 13**

#### **Përgjegjësitë**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajet kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.



Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Ortaku që nuk është administrator, ka të drejtë në çdo kohë të informohet personalisht për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentet e shoqërisë.

#### **Neni 14** **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKR dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### **Neni 15** **Bilanci i shoqërisë dhe dividendet**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratoret.

Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendeve, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji, në raport me kuotat e zotëruara nga secili prej ortakëve.

#### **Neni 16** **Ekspertet**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollin periodik të ushtruar prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e Asamblesë së Ortakëve.

Në përfundim të kontrollit ekspertit kontabel i autorizuar për gatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollin periodik të ushtruar, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që kanë.

#### **Neni 17**

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim të ortakëve, i cili jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre por vendos në lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të mëtejshëm të shoqërisë dhe garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecantë, krijimin e Rezervës Ligjore. Rezerva e Ligjore krijohet vit pas viti nëpërmjet lënies mënjane të një shume të barabartë me 5% të fitimit neto të realizuar gjatë secilit vit financiar, deri sa të arrihet një shume e barabartë me 10% të kapitalit themelues të Shoqërisë.

#### **Neni 18**

Të ardhurat neto ( Dividenti ) që mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimit të pagesave ndaj të tjerëve, i mbesin dhe i kalojnë në pronësi, ortakëve të shoqërisë.

#### **Neni 19**



### **Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar sic mund të jene :

- a) Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.
- b) Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"
- c) Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper " .

### **Neni 20**

#### **Bashkimi dhe ndarja**

Shoqëria, me anë të bashkimit, mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo themelon.

Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.

Ortakët e shoqërise, që bëjnë kalimin e trashëgimisë së saj në kuadrin e operacioneve të përmendura me lart përfitojnë pjesë të kapitalit themeltar nga shoqëria ose shoqëritë përfituese dhe sipas rastit një kompensim me para, vlera e të cilit nuk mund të kalojë 10 për qind të vlerës Nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhëna. Operacionet e përmendura me lart mund të realizohen ndërmjet shoqërive të formave të ndryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim të shoqërise që zhduket, dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj të shoqëritë përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërive që zhduken marrjen e cilësisë së ortakëve të shoqërive përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.

### **Neni 21**

Afati i emerimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat që duhen depozituar ne Qendren Kombetare te Biznesit.

### **Neni 22**

Likuidatori eshte i detyruar qe të jete i vemendshem dhe korekt, si per realizimin e të drejtave per subjektet ndaj të cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debive qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve të vecante apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj.

### **Neni 23**

Cdo mosmarrveshje apo konflikt qe mund të lind gjate ushtrimit të veprimtarise se Shoqerise si rregull dhe pergjithesisht ortakët duhet ta zgjidhin me mirekuptim, ne të kunderten ceshtja mund të behet objekt konflikti gjyqsor ne Gjykates e Rrethit Gjyqsor Tirane.

### **Neni 24**



### Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

### Neni 25

#### Mosmarveshjet

Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

### Neni 26

#### Dispozita perfundimtare

Ky statut u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare, nenshkruset ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij dhe vulen.

**O R T A K U I V E T E M "Planet APP" SH.P.K  
SILVER TOPALLI**

SILVER TOPALLI



Tirane, më 18.06.2021